

9 gusht 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Më në fund – hetime për krimin urbanistik në Prizren

EC Ma ndryshe edhe gjatë muajit korrik dhe pjesës së parë të muajit gusht ka vazhduar me monitorimin e punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në fokus të monitorimit ka qenë sërish sektori i urbanizmit dhe ndërtimet e objekteve të banimit kolektiv në qytetin e Prizrenit.

Në njërën nga kërkesat për qasje në dokumente publike, EC Ma Ndryshe ka kërkuar nga ekzekutivi i komunës lejet ndërtimore për objektet e banimit kolektiv nga viti 2007, bashkë me dëshmitë dhe dosjet e këtyre projekteve për të parë nëse ato janë realizuar konform lejeve ndërtimore. Në përgjigjen e Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor për këtë kërkesë është dhënë njoftimi se “të gjitha dosjet e lëndëve të objekteve kolektive gjenden në Institucionin Policor” (bashkëngjitur letra e kësaj drejtorie). Ndërkohë dje, ky lajm u konfirmua edhe nga Prokuroria e Qarkut në Prizren, e cila ka autorizuar hetuesit përkatës të Policisë së Kosovës që të nisin hetimet në lidhje me dyshimet për parregullsitë në ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv dhe tejkalimin e planeve urbanistike në zonat e ndryshme të qytetit.

EC Ma Ndryshe shpreh mirënjohjen e saj për këtë iniciativë të organeve të drejtësisë dhe rendit, e cila po ndodh pas raportimeve të rregullta të organizatës sonë muajve të fundit në lidhje me parregullsitë urbanistike në Prizren. Në mënyrë që kjo të mos mbetet një iniciativë në tentativë, EC Ma Ndryshe apelon për një bashkërendim të veprimeve nga organet përkatëse, në mënyrë që shkelësit e planeve rregullative urbane dhe ligjeve të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor të përgjigjen para drejtësisë.

Si kontribut shtesë në përpjekjet për të sjellë rend urbanistik në Prizren, EC Ma Ndryshe ofron fakte të reja të parregullsive urbanistike. Gjatë muajit korrik, monitoruesit dhe aktivistët e organizatës kanë evidentuar tejkalime dhe mosrespektime të reja të planeve urbanistike nga ndërtuesit e objekteve të banimit kolektiv. Pos mungesës së sigurisë gjatë kryerjes së punimeve ndërtimore, segment që nuk monitorohet nga ekzekutivi komunal, këta investitorë shkelin edhe planet rregullative të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Edhe përkundër miratimit të planeve rregulluese, investues të ndërtesave kolektive në lagjen “Jeni Mëhalla” nuk i respektojnë kriteret e ndërtimit. Në fotografinë e parë (të bashkëngjitur në këtë komunikatë) është evidentuar tejkalimi në etazhitet nga investitori përkatës, ndërsa i njëjti ndërtim ka tejkalime edhe në hapësirën ndërtuese duke mos e respektuar asnjë normë ligjore në fuqi që rregullon fushën e ndërtimeve kolektive. Në një tjetër rast (fotografia e dytë), pos uzurpimit të pronës publike (përkatësisht ngastrës kadastrale 4784-0) nga investitori afër parkut të qytetit (Rruga William Walker), në këtë lokacion punimet



vazhdojnë të kryhen pa lejen ndërtimore nga ekzekutivi komunal. Pos këtyre dy rasteve dhe derisa të verifikojë dokumentet dhe të përfundojë monitorimin në terren, EC Ma Ndryshe ditëve në vijim do të publikojë raste të reja të parregullsive në sektorin e ndërtimeve të objekteve të banimit kolektiv në Prizren.

EC Ma Ndryshe konsideron se Kryetari i Komunës së Prizrenit duhet të mbajë përgjegjësinë finale për ndërtimin e objekteve të banimit kolektiv jashtë kritereve urbanistike. Mungesa e gatishmërisë së Kryetarit të Komunës për t'u ballafaquar me këta ndërtues, krijon hapësirë për dyshime rreth përfshirjes së ekzekutivit të komunës në "krimin urbanistik" që e ka kapluar Prizrenin viteve të fundit. Tolerime të këtilla nga ekzekutivi i komunës, i thellojnë edhe më tepër dyshimet se për shpërdorim të detyrës zyrtare dhe përfitime personale të zyrtarëve të ekzekutivit komunal. Prandaj, hetimet që është duke i zhvilluar Prokuroria e Qarkut në Prizren, do të duhej të ndriçonin këto dhe shumë dyshime të tjera, të cilat EC Ma Ndryshe po i ngrit rregullisht në mënyrë të faktuar.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit korrik përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +386 49 116 448